



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 921/1 Prot

Tiranë, më 18/03/2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

**DREJTORISE RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE SHKODËR**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimt nga detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” i ndryshuar dhe shkresës nr.234 prot, datë 09.02.2022 “Njoftim për vend të lirë pune”, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Shkodër, protokolluar në AKPA me nr.921 prot, datë 15.03.2022, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Shkodër, brenda datës 21.03.2022, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- 1 Specialist në Sektorin e Menaxhimit e Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Shkodër;

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Bachelor;
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirim të detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me kodin e punës” i ndryshuar;
- c. fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës
- d. fotokopje të librezës së punës (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune);
- e. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- f. certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h. vërtetim të gjendjes gjyqësore (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë)
- i. vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi (përfshihen ato që janë në proces gjyqësor por të dëshmuara) (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune);
- j. Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Shkodër.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, brenda datës 05.04.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

